



## BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

### KOMISIONI I PROVIMEVE TË AFTËSIVE PROFESIONALE

21.09.2024

*“Zbatimi në praktikë i kërkesave të etikës profesionale dhe të biznesit”*

#### ALTERNATIVA (22 x 1 pikë)

**1. Cilat janë shërbimet e auditimit të ndaluara për një auditues ligjor / shoqëri auditimi të angazhuar në auditimin e njësisë ekonomike me interes publik, gjatë periudhës ndërmjet fillimit të periudhës së audituar dhe lëshimit të raportit të auditimit?**

- a) Shërbime që lidhen me funksionin e auditimit të jashtëm të njësisë ekonomike të audituar;
- b) Shërbime që kërkojnë pjesëmarrjen në drejtim apo vendim-marrje të njësisë ekonomike të audituar;
- c) Në të gjitha rastet shërbimet e konsulencës tatimore që lidhen me shërbime mbështetëse që lidhen me kontrollet tatimore nga autoritetet tatimore edhe kur ofrimi i këtij shërbimi nga audituesi ligjor/shoqëria e auditimit vjen si rrjedhojë e kërkesës ligjore;
- d) Hartimi dhe zbatimi i procedurave të kontrollit të brendshëm apo të menaxhimit të riskut që lidhet me përgatitjen dhe/ose të kontrollit të raportimit financiar apo hartimin dhe zbatimin e sistemeve informatike të raportimit financiar
- e) Të gjitha mësipër

Përgjigja e saktë është alternativa E

**2. Audituesi ligjor nuk mund ta ushtrojë profesionin:**

- a) Në mënyrë individuale;
- b) Si një ortak/aksionar pjesëmarrës në kapitalin e një shoqërie
- c) Jo i punësuar te një tjetër auditues ligjor i regjistruar.
- d) Si shef finance ne kompaninë që auditon
- e) Në momentin kur sapo është rregjistruar për të ushtruar profesionin konform ligjit.

Përgjigja e saktë është alternativa D

**3. Funkzioni i audituesit ligjor është i papajtueshëm me çdo angazhim, si i punësuar, me përjashtim të:**

- a) Pjesëmarrjes në seminare, konferenca apo veprimtari të ngjashme me to
- b) I punësuar te një tjetër auditues ligjor i regjistruar.
- c) Ushtrimit të veprimtarisë së mësimdhënies me kohë të pjesshëm;
- d) Pjesëmarrjes si aksionar i njësisë ekonomike që auditon
- e) Të gjitha të mësipërme

Përgjigja e saktë është alternativa E

**4. Një auditues ligjor në Dhjetor të vitit 2021, realizoi angazhimin në një shoqëri ujësjellësi në rrethin Vlorë. Në Qershor të vitit 2023 Shoqëria e ujësjellësit Vlorë i propozon, audituesit që të kryejë funksionin e drejtimit të sektorit të menaxhimit të aseteve dhe të risqeve. Në lidhje me ofertën e propozuar;**

- a) Audituesi nuk duhet ta pranojë, pasi nuk përmbushet kërkesa ligjore e lidhura me pavarësinë.
- b) Audituesi ligjor duhet ta pranojë, sepse periudha një vjecare ka kaluar dhe nuk cënohet parimi i pavarësisë.
- c) Audituesi ligjor nuk duhet ta pranojë, sepse atij do ti duhet të ushtrojë funksion në shoqërinë që ka audituar më parë.
- d) Të gjitha të mësipër
- e) Asnjëra

**Përgjigja e saktë është alternativa A**

**5. Cilat nga rastet e mëposhtme janë shërbime jo auditimi të ndaluara, që një auditues nuk duhet ti kryejë për njësinë ekonomike të audituar, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë;**

- a) Identifikimi i subvencioneve dhe lehtësirave tatimore (fiskale).
- b) Ofrimi i shërbimit të konsulencës në lidhje me legjislacionin tatimor.
- c) kryerjen e këshillimit ligjor të përgjithshëm.
- d) Të gjitha mësipër
- e) Asnjëra nga përgjigjet

**Përgjigja e saktë është alternativa D**

**6. Cilat nga citimet e mëposhtme përfshin Sjellja Profesionale si një nga pesë parimet themelore të etikës për profesionistët kontabël:**

- a) Të respektojë konfidencialitetin për informacionet që ai merr si rrjedhojë e marrëdhënieve profesionale dhe të biznesit.
- b) Të sillet në një mënyrë që është në koherencë me përgjegjësinë e profesionit për të vepruar në interes të publikut në të gjitha aktivitetet e tij profesionale dhe marrëdhëniet e biznesit;
- c) Të veprojë me kujdes dhe në pajtim me standardet e zbatueshme profesionale dhe teknike.
- d) Të gjitha mësipër
- e) Asnjëra nga të mësipërmet

**Përgjigja e saktë është alternativa B**

**7. Shërbimet jo auditimi lejohen të kryehen në rastin kur:**

- a) Efekti i tyre është jo material në mënyrë të veçantë apo së bashku në pasqyrat financiare të audituara;
- b) Vlera e efektit që kanë në pasqyrat financiare të audituara nuk është dokumentuar dhe argumentuar në mënyrë të qartë në raportin shtesë për komitetin e auditimit
- c) Audituesi ligjor është në pajtueshmëri me kërkesat përkatëse të Kodit të Etikës
- d) Alternativat a dhe b
- e) Alternativat a, b, c
- f) Alternativat a, dhe c

**Përgjigja e saktë është alternativa F**

**8. Audituesi ligjor ose shoqëria audituese, që kryen auditimin ligjor të pasqyrave financiare të një njësie ekonomike me interes publik konfirmon:**

- a) Çdo vit pavarësinë e vet nga subjekti i audituar
- b) Çdo 2 vjet pavarësinë e vet nga subjekti i audituar
- c) Vetëm kur kryen angazhimin e auditimit.
- d) Të gjitha mësipër
- e) Asnjëra nga të mësipërmet

Përgjigja e saktë është alternativa A

**9. Cili është qëllimi kryesor i Kodit të Etikës së IESBA?**

- a) Të promovojë transparencën në raportimin financiar.
- b) Të sigurojë që audituesit veprojnë në interesin publik.
- c) Të rregullojë konkurrencën midis firmave të auditimit.
- d) Të promovojë marrëdhënie të ngushta me klientët
- e) Asnjë nga të mësipër

Përgjigja e saktë është alternativa B

**10. Cili është përkufizimi i "pavarësisë në pamje" sipas Kodit të Etikës së IESBA?**

- a) Pavarësia e audituesit ligjor në të menduar.
- b) Pavarësia e audituesit ligjor në marrjen e vendimeve
- c) Aftësia e një pale të tretë për të vlerësuar pavarësinë e audituesit ligjor.
- d) Pavarësia kundrejt organeve qeverisëse të subjektit që po auditohet.
- e) Të gjitha mësipër

Përgjigja e saktë është alternativa C

**11. Kërcënimet për pajtueshmërinë me parimet themelore të audituesit ligjor nuk përfshin:**

- a) Interesin vetjak
- b) Familjariteti
- c) Ndërprerja e angazhimit
- d) Frikësimi
- e) Të gjitha mësipër

Përgjigja e saktë është alternativa C

**12. Cila nga këto më poshtë është e saktë në lidhje me pavarësinë e shoqërisë audituese, që kryen auditimin ligjor të pasqyrave financiare të një njësie ekonomike me interes publik:**

- a) Paraqet çdo vit pranë komitetit të auditimit shërbimet e tjera shtesë, që i ka ofruar subjektit të audituar.

- b) Paraqet një herë ne tre vjet pranë komitetit të auditimit shërbimet e tjera shtesë, që i ka ofruar subjektit të audituar.
- c) Paraqet pranë komitetit të auditimit vetëm tarifat që lidhen me shërbimet e auditimit.
- d) Të gjitha mësipër
- e) Asnjëra nga përgjigjet a), b), c)

Përgjigja e saktë është alternativa A

**13. Kur zëvendësohet audituesi ligjor/shoqërisë audituese, pa përfunduar angazhimi i auditimit ligjor, audituesi ligjor/shoqëria audituese e zëvendësuar duhet të vënë në dispozicion të pasardhësit të gjithë evidencën përkatëse të auditimit të mbledhur.**

- a) Po, është e vërtetë pasi audituesi ligjor/shoqëria audituese duhet të jetë transparente me pasardhësin.
- b) Jo, nuk është e vërtetë pasi audituesi ligjor/shoqëria audituese nëse jep këtë informacion shkel konfidencialitetin dhe sekretin profesional.

Përgjigja e saktë është alternativa A

**14. Tarifa e shërbimit të auditimit ligjor për njesitë ekonomike nuk duhet të jetë influencuar apo përcaktuar në funksion të kryerjes së shërbimeve të tjera për njesinë ekonomike të audituar:**

- a) E sakte pasi duhet të ruhet pavarësia
- b) E gabuar, pasi audituesi ligjor lejohet të kryejë edhe shërbime të tjera jo-auditimi dhe që t'i kryejë ato duhet të vendosë një tarifë me të ulët për shërbimin e auditimit për të qenë konkurrent në treg.

Përgjigja e saktë është alternativa A

**15. Gjate procesit të auditimit, audituesi ligjor vuri re disa transaksione të klientit të cilat janë të dyshimta dhe në bazë të ligjit për pastrimin e parave ato duhet të raportohen. A po shkel audituesi ligjor parimin e konfidencialitetit duke bërë këtë raportim?**

- a) Po, kryen shkelje të parimit të konfidencialitetit.
- b) Jo, nuk kryen shkelje të parimit të konfidencialitetit.
- c) Audituesi nuk ka detyrim të raportojë transaksionet e dyshimta
- d) Audituesi nuk kontrollon transaksionet e klientit
- e) Audituesi nuk është subjekt i ligjit për pastrimin e parave.

Përgjigja e saktë është alternativa B

**16. Zbulimi i një gabimi të rëndësishëm gjatë rivlerësimit të punës nga vetë audituesi ligjor është:**

- a) Kërcënim i objektivitetit
- b) Kërcënim i vetë-rishikimit
- c) Kërcënim i frikësimit

- d) Të gjitha mësipër
- e) Asnjë nga mësipër

**Përgjigja e saktë është alternativa B**

**17. Kontabilisti i miratuar ofron shërbime të hartimit të pasqyrave financiare për klientin A; dhe gjatë punës së tij ai vë re se klienti ka hartuar një deklaratë të rreme në lidhje me deklaratimet e listëpagesave. Cilat nga këto me poshtë është e sakte:**

- a) Kontabilisti i miratuar duhet të diskutojë me klientin këtë çështje dhe nëse rrezikohet parimi i objektivitetit duhet të heqë dorë nga angazhimi për hartimin e pasqyrave financiare.
- b) Deklarimi i listëpagesave nuk ka lidhje me hartimin e pasqyrave financiare kështu që Kontabilisti i Miratuar mund të veprojë sikur nuk është në dijeni të deklaratës së rreme.
- c) Asnjë nga alternativat

**Përgjigja e saktë është alternativa A**

**18. Bazuar në Kodin e Etikës së IEASB testi i arsyeshëm dhe i informuar i palës së tretë është:**

- d) Një vlerësim nga profesionisti kontabël nëse të njëjtat përfundime do të mund të arriheshin nga një palë tjetër.
- e) Këndvështrimi i një pale të tretë të arsyeshme dhe të informuar, e cila peshon të gjitha faktet dhe rrethanat përkatëse që profesionisti kontabël di;
- f) Vlerësimi i palës së tretë e arsyeshme dhe e informuar, e cila nuk ka nevojë të jetë një profesionist kontabël
- g) Të gjitha alternativat e mësipërme;
- h) Asnjëra

**Përgjigja e saktë është alternativa G**

**19. Kur profesionisti kontabël identifikon një kërcënim mbi pajtueshmërinë me parimet themelore, ai do të vlerësojë nëse një kërcënim i tillë është.**

- a) Për t'u terhequr nga angazhimi
- b) Për t'u pranuar si angazhimi me kusht
- c) Në një nivel të pranueshëm
- d) Të gjitha alternativat
- e) Asnjë nga alternativat

**Përgjigja e saktë është alternativa C**

**20. Një auditues ligjor, në rastin e zbatimit të masave mbrojtëse për të adresuar një kërcënim dokumenton cilat nga sa me poshte:**

- a) Natyrën e kërcënimit

- b) Masat mbrojtëse të zbatuara
- c) Orët e harxhuara për masat mbrojtëse
- d) Asnjë nga alternativat e mësipërme
- e) a dhe b me lart

Përgjigja e saktë është alternativa E

**21. Sipas ligjit Nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor...” audituesi ligjor që nga koha kur ka dhënë dorëheqjen, nuk ka të drejtë të pranojë ose të kryejë funksione të rëndësishme drejtimi në njësinë ekonomike të audituar pa kaluar një periudhë kohe prej të paktën:**

- a) 1 vit për çdo njësi ekonomike;
- b) 2 vite për çdo njësi ekonomike;
- c) 2 vite për njësi ekonomike me interes publik;
- d) 3 vite për njësi ekonomike me interes publik;
- e) Asnjë nga alternativat e mësipërme

Përgjigja e saktë është alternativa C

**22. Sipas Kuadri konceptual profesionisti kontabël e vlereson nivelin e pranueshëm si një nivel në të cilin është në përputhje me parimet themelore duke aplikuar cfare nga sa me poshte:**

- a) Testin e arsyeshëm dhe të informuar të palës së tretë;
- b) Të arrijë në përfundimin se profesionisti kontabël është në përputhje me parimet themelore
- c) Vetëm a.
- d) Vetëm b;
- e) a dhe b

Përgjigja e saktë është alternativa E

## **PYETJE ME SHITJELLIM (4 pikë secila pyetje)**

**Pyetje 1:** Çfarë është konfidencialiteti në profesionin e audituesit? Listoni disa nga rrethanat kur nga profesionistët e auditimit kërkohet apo mund të kërkohet të japin informacione konfidenciale, ose kur dhënia e këtyre informacioneve, mund të jetë e përshtatshme.

### **Përgjigje:**

Konfidencialiteti i shërben interesit publik, pasi ai lehtëson rrjedhjen e lirë të informacionit nga klienti i profesionistit kontabël ose nga organizata punëdhënëse tek profesionisti kontabël, duke patur parasysh se informacioni nuk do t'i jepet një palë të tretë. Megjithatë më poshtë jepen rrethanat, kur profesionistët kontabël kërkohet apo mund të kërkohet të japin informacione konfidencial, ose kur dhënia e këtyre informacioneve, mund të jetë e përshtatshme:

- (a) Dhënia e informacioneve kërkohet nga ligji, për shembull:
  - (i) Prodhimi i dokumenteve ose dhëniet e tjera të evidencës, gjatë procedurave ligjore, apo
  - (ii) Informimi i autoriteteve përkatëse publike, për informacionet që kanë të bëjnë shkeljet e ligjit; dhe
- (b) Dhënia e informacioneve lejohet me ligj dhe autorizohet nga klienti ose organizata punëdhënëse;
- (c) Ekziston një detyrim ose një e drejtë profesionale për dhënien e informacioneve, kur nuk ndalohet nga ligji:
  - (i) Për të vepruar në pajtim me procedurat e kontrollit të cilësisë të një organizmi profesional;
  - (ii) Për t'iu përgjigjur një kërkesë ose një investigimi të bërë nga një organizëm profesional ose rregullator;
  - (iii) Për të mbrojtur interesat profesionale të një profesionisti kontabël gjatë proceseve gjyqësore; ose
  - (iv) Për të respektuar standardet teknike dhe profesionale, përfshirë kërkesat etike.

**Pyetje 2:** Listoni dy shembuj për secilin nga rreziqet e cënimit të objektivitetit, interesit vetjak dhe frikësimit.

### **Përgjigje:**

#### **a) Rreziku i cënimit të objektivitetit**

Ky rrezik ndodh nëse audituesi humbet paanshmërinë për shkak të faktorëve të jashtëm ose të brendshëm.

- **Shembull 1:** Audituesi ka një marrëdhënie personale të ngushtë me një anëtar të bordit të drejtuesve, gjë e cila ndikon në vendimmarrjen e tij gjatë procesit të auditimit.

- **Shembull 2:** Pranimi i dhuratave përtej vlerave të pranuar ose favorizimeve nga klienti mund të ndikojë në opinionin e auditimit.
- **Shembull 3:** Audituesi ka marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes për disa çështje të rëndësishme financiare të shoqërisë dhe tani duhet të auditojë të njëjtat vendime.
- **Shembull 4:** Audituesi i një shoqërie të re është ish-punonjës i shoqërisë që auditohet, çka mund të krijojë paanshmëri të dyshuar gjatë procesit të auditimit.

#### b) Rreziku i interesit vetjak

Ky rrezik lind nëse audituesi ka një interes personal apo financiar që mund të ndikojë në vendimet e tij.

- **Shembull 1:** Audituesi ka pjesë ose aksione në shoqërinë që po auditon, gjë që krijon një konflikt të interesit financiar.
- **Shembull 2:** Firma e auditimit ofron shërbime këshillimi për klientin dhe mund të ndikohet nga marrëdhënia e ngushtë që ka me të për qëllim të ruajtjes së marrëdhënies së biznesit afatgjatë.
- **Shembull 3:** Audituesi i ka dhënë një kredi personale manaxherit të shoqërisë që po auditohet, duke krijuar një lidhje financiare të ndjeshme.
- **Shembull 4:** Firma e auditimit është e varur ekonomikisht nga klienti për një pjesë të madhe të të ardhurave të saj dhe mund të komprometohet për të mos humbur kontratën.

#### c) Rreziku i frikësimit

Ky rrezik ndodh nëse audituesi ndjen presion nga klienti ose faktorë të tjerë që mund të ndikojnë në gjykimin e tij.

- **Shembull 1:** Drejtimi i shoqërisë kërcënon audituesin se do të ndërpresë kontratën nëse audituesi nuk përfshin një opinion të favorshëm.
- **Shembull 2:** Stafit të ekipit të auditimit i krijohet presion nga kolegët e niveleve më të larta për të ndjekur një drejtim të caktuar të auditimit, ndryshe ai mund të përballet me pasoja në karrierën e tij.
- **Shembull 3:** Klienti sugjeron se do të padisë firmën e auditimit nëse nuk merr një opinion sipas pritshmërisë së tij.
- **Shembull 4:** Klienti krijon një atmosferë frikësimi duke refuzuar të bashkëpunojë me audituesit dhe duke vënë në presion për dorëzimin e një raporti të caktuar brenda afateve të ngushta.

**Pyetje 3:** Listoni duke shpjeguar shkurtimisht cilat janë kontrollet e cilësisë, të aplikueshme për angazhimet e auditimit.

#### Përgjigje:

Sipas rregullores nr. 7, datë 02.10.2018, për procedurat, metodologjinë dhe organizimin e kontrollit të cilësisë së auditimit ligjor, lëshuar nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike, ekzistojnë disa tipologji të kontrolleve të cilësisë për entitetet me interes publik dhe ato që nuk janë me interes publik:

##### **a. Për entitetet me interes publik:**

- Kontroll më i rreptë dhe i shpeshtë: Angazhimet e auditimit të entiteteve me interes publik (si banka, shoqëri sigurimi, etj) i nënshtrohen kontrolleve të jashtme të cilësisë më të shpeshta dhe më të hollësishme.
- Raportim i detajuar dhe transparencë më e lartë: Audituesit e entiteteve me interes publik duhet të përmbushin kërkesa më strikte për transparencën dhe publikimin e informacionit.
- Përgjegjësi më e madhe për rrezikun sistematik: Duke pasur parasysh rëndësinë e entiteteve me interes publik për stabilitetin ekonomik, audituesit përfshihen në vlerësimin e rrezikut sistematik



**b. Për entitetet që nuk janë me interes publik:**

- Kontrolle më të lehta dhe më të rralla: Për entitetet jo me interes publik, kontrollet e jashtme të cilësisë kryhen më rrallë dhe me një nivel më të ulët formalizimi.
- Rregulla të thjeshtuara për raportim: Nuk kërkohet një transparencë e barasvlefshme me atë të interesit publik, megjithatë parimi i kompetencës dhe kujdesit duhet aplikuar njëjloj gjatë kontrollit të cilësisë edhe për këto angazhime.

**c. Kontrollë të tjera, lidhur me sigurimin e cilësisë dhe integritetin e auditimeve ligjore në përputhje me kërkesat rregullatore dhe standardet profesionale.**

- Kontrolli i cilësisë së brendshme: Kryhet nga firmat e auditimit për të siguruar që standardet dhe procedurat e brendshme janë ndjekur në mënyrë rigorozë dhe që proceset e brendshme të punës janë ngritur në një formë të përshtatshme.
- Kontrolli i jashtëm të cilësisë: Organizuar nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike ose autoritetet e tjera kompetente për të verifikuar cilësinë e auditimeve të kryera.
- Kontrolli i përputhshmërisë me standardet: Sigurimi që firmat e auditimit përputhen me standardet ndërkombëtare të auditimit dhe rregulloret kombëtare, e cila kryhet edhe së brendshmi nga firmat e auditimit po ashtu dhe nga BMP.
- Vlerësimi i pavarësisë dhe paanshmërisë: Kontrolli që audituesit kanë vepruar në mënyrë të pavarur dhe paanshme gjatë gjithë angazhimit të auditimit, e cila kryhet edhe së brendshmi nga firmat e auditimit po ashtu dhe nga BMP.
- Dokumentimi dhe arkivimi: Verifikimi që dokumentacioni i auditimit është i plotë, i saktë dhe i ruajtur sipas kërkesave ligjore dhe profesionale, e cila kryhet edhe së brendshmi nga firmat e auditimit po ashtu dhe nga BMP.
- Kualifikimi dhe trajnimi: Sigurimi që stafi i angazhuar në auditim ka kualifikimet dhe përgatitjen e nevojshme për të kryer detyrat e tyre.

**Pyetje 4:** Juliani është një auditues ligjor dhe se fundi ka audituar pasqyrat financiare të dy njësive ekonomike me aktivitet financiar. Në mbremje ai ka dalë me shokët dhe ata e pyesin në bisede e sipër për pagat e CEO së shoqërisë dhe a ka mundësi shoqëria të japër kredi me norma të ulta interesi.

Bazuar në parimet themelore të etikës, si duhet të veproje Juliani në lidhje me dy informacionet që i kërkohen (pagat dhe normat e interesit)?

**Përgjigje:**

Bazuar në parimet themelore të Kodit të Etikës, Juliani duhet të respektojë parimin e konfidencialitetit për informacionet që ai merr si rrjedhojë e punës së tij. Juliani nuk duhet t'ua tregojë këto informacione paleve të treta pa patur autorizimin e duhur dhe specifik, përveç rasteve kur, për dhenien e këtyre informacioneve ekziston e drejta apo detyrimi profesional. Në këto kushte, Juliani nuk mund të ndajë me shoket informacionin në lidhje me pagën e CEO pasi ky është një informacion konfidencial dhe ai s'ka as autorizimin dhe as detyrimin për ta dhënë.

Përsa i takon mundësitë për dhenie kredie me norma interesi të ulëta, Juliani mund të japë informacion vetëm nëse ai është i vlefshëm edhe për publikun (psh në website të shoqërisë etj). Përndryshe, nëse ky informacion është konfidencial për shoqërinë, atëherë Juliani nuk mund ta ndajë me shoket.

**Pyetje 5:** Shtjelloni çfarë përcakton Kodi i Etikës së IEKA në lidhje me parimin e sjelljes profesionale dhe testin e palës së tretë në lidhje me këtë parim.

### **Përgjigje:**

Parimi i sjelljes profesionale percakton detyrimin që auditori ligjor të respektojë ligjet dhe rregullat dhe të menjanojë çdo veprim që mund të diskreditojë profesionin. Ky detyrim duhet të mbahet parasysh në çdo kohë dhe për çdo veprim që kryen auditori ligjor. Këtu përfshihen edhe ato veprime, që një pale e tretë e informuar dhe e arsyeshme, e cila ka njohuri për të gjithë informacionet respektive, do të vlerësojë si veprime me ndikime negative ndaj reputacionit të mirë të profesionit. Për të rastet kur auditori ligjor ka dyshime në lidhje me respektimin e parimit të sjelljes profesionale, ai mund të perdorë palën e tretë e cila do të japë një gjykim të pavarur në lidhje me rastin specifik.

**Pyetje 6:** Albana është një audituese ligjore dhe ajo auditon dy shoqëri “Drita” dhe “Albon” të cilat futen në një konflikt gjyqësor. Shoqëria Drita i kërkon Albanës që të ofrojë konsulentë në lidhje me disa aspekte financiare të këtij konflikti gjyqësor.

Komentoni mbi çështjet etike të ngritura, dhe rekomandoni çdo veprim që duhet të ndërmerret nga Albana në lidhje me këtë situatë.

### **Përgjigje:**

Albana duhet të ndermarre hapa të arsyeshëm për të identifikuar nëse ka rrethana që e bëjnë të ndodhet përpara një konflikti interesi. Këto rrethana mund të çojnë në kercënime kundrejt respektimit të parimeve themelore. Meqenëse ajo po punon për shoqërinë “Drita” mund të krijohet një kercënim ndaj objektivitetit ose konfidencialitetit, meqenëse dy shoqëritë janë në konflikt me njëra-tjetrën. Në këtë rast Albana, duhet të analizojë çështjen që është objekt konflikti si dhe çfarë konsulence duhet të ofrojë konkretisht. Nëse dhe me masat e marra nga Albana, kercënimet ndaj objektivitetit ose konfidencialitetit nuk zvogelohen në nivel të pranueshëm, ajo nuk duhet ta pranojë angazhimin e konsulencës.

**Pyetje 7:** Çfarë janë masat mbrojtëse? Jepni shembuj të veprimeve që në rrethana të caktuara mund të shërbejnë si masa mbrojtëse për adresimin e kercënimeve?

### **Përgjigje:**

Masat mbrojtëse janë veprime, individuale ose të kombinuara, që profesionisti kontabël ndërmerr, të cilat në mënyrë efektive reduktojnë kercënimet për pajtueshmërinë me parimet themelore në një nivel të pranueshëm. Shembuj të disa nga këto veprime mund të jenë si më poshtë:

- Caktimi i kohës shtesë dhe personelit të kualifikuar për detyrat e kërkuara kur një angazhim është pranuar, mund të adresojë një kercënim interesi vetjak.
- Caktimi i një rishikuesi të përshtatshëm që nuk ishte anëtar i grupit, për të rishikuar punën e kryer ose këshilluar sipas nevojës, mund të adresojë një kercënim vetë rishikimi.
- Përdorimi i partnerëve dhe grupeve të ndryshme të angazhimit me linja të veçanta raportimi për ofrimin e shërbimeve jo të sigurisë për një klient mund të adresojë në kercënime të vetë rishikimit, favorizimit ose familjaritetit.
- Përfshirja e një firme tjetër për të kryer ose ri kryer një pjesë të angazhimit mund të adresojë kercënime interesi vetjak, vetë rishikimi, favorizimi, familjariteti ose kercënime frikësimi.
- Ndarja me klientët e informacionit lidhur me tarifa referimi ose marrëveshje komisionesh të marra për rekomandimin e shërbimeve ose produkteve, mund të adresojë kercënime interesi vetjak.

- Ndarja e grupeve kur kanë të bëjnë me çështje të një natyre konfidenciale, mund të adresojë një kërcënim interesi vetjak.
- Marrjen e asistencës apo trajnimit nga dikush me ekspertizën e nevojshme.
- Garantimin se ekziston koha e mjaftueshme për të përfunduar detyrat përkatëse.
- Informimi i niveleve të larta të drejtimit ose i personave të ngarkuar me qeverisjen e organizatës punëdhënëse të profesionistit kontabël apo të ofruesit lidhur me ofertën.
- Ndryshimi ose ndërprerja e marrëdhënieve të biznesit me ofertuesit.

**Pyetje 8:** Një klienti auditimi, që nuk është një entitet me interes publik, i jepet shërbimi këshillimi tatimor dhe shërbimeve të planifikimit tatimor. Cilat veprime mund të shërbejnë si masa mbrojtëse për të adresuar kërcënimin e vetë-rishikimit?

**Përgjigje:**

Shembuj të veprimeve që mund të shërbejnë si masa mbrojtje për të adresuar kërcënimet e vetë-rishikimit ose të favorizimit të krijuara nga dhënia e këshillimit tatimor dhe shërbimeve të planifikimit tatimor një klienti të auditimit, që nuk është entitet me interes publik mund të jene si me poshte:

- Angazhimin e profesionistëve që nuk janë pjesë e ekipit të auditimit në kryerjen e shërbimit, mund të adresojë kërcënimet e vetë rishikimit ose favorizimit.
- Angazhimin e një rishikuesi të përshtatshëm, i cili nuk ka qenë i përfshirë në dhënien e shërbimit, për rishikimin e punës audituese ose të shërbimit të kryer, mund të adresojë një kërcënim vetë rishikimit.
- Marrjen e një vërtetimi paraprak nga autoritetet tatimore në lidhje me detyrimet, mund të adresojë kërcënimet e vetë-rishikimit ose favorizimit.

**Pyetje 9:** Kërcënimi i egoizmit, familjaritetit ose frikësimit mund të krijohet kur një anëtar i grupit të auditimit; ose një anëtar i drejtpërdrejtë i familjes së këtij individi; ose firma; ose një firmë rrjet, ka një interes financiar në një entitet, kur një drejtor, një zyrtar ose pronar kontrollues i klientit të auditimit, dihet gjithashtu, që ka një interes financiar në këtë entitet. Shtjelloni shembuj të masave mbrojtëse që mund të eliminojnë një kërcënimin e egoizmit.

**Përgjigje:**

Shembuj të veprimeve që mund të shërbejnë si masa mbrojtëse për trajtimin e kërcënimin të egoizmit, familjaritetit ose frikësimit kur një anëtar i grupit të auditimit, ose një anëtar i drejtpërdrejtë i familjes së këtij individi , ose firma, ose një firmë rrjet, ka një interes financiar në një entitet, kur një drejtor, një zyrtar ose pronar kontrolluesi klientit të auditimit, dihet gjithashtu, që ka një interes financiar në këtë entitet:

- Zgjidhjen, sa më shpejt të jetë e mundur, e të gjithë interesave financiare nga anëtari i afërt i familjes, ose zgjidhja e pjesshme e një interesi financiar jo të drejtpërdrejtë, deri në nivelin që interesi i mbetur të mos jetë më material.
- Largimin e individit nga grupi i auditimit

## USHTRIME (6 pikë secila pyetje)

### Ushtrimi 1

Aktualisht jeni në fazën e planifikimit të auditimit të shoqërisë “DEN” dhe keni zhvilluar disa takime me CFO dhe CEO e shoqërisë referuar analizës së pasqyrave financiare. Partneri i angazhimit ju ka njoftuar që do të zhvillojë një takim me ortakët e tjerë – audituesit ligjorë të shoqërisë, në të cilën do të diskutojnë me detaje për cdo angazhim, ndaj i nevojitet informacioni i mbledhur nga takimet e zhvilluara me CEO dhe CFO.

*Kërkohet:* Evidentoni kërcënime të etikës profesionale? Nëse po, cfarë masash do t'i propozonit ortakut?

### Përgjigje:

**Ky skenar karakterizohet nga disa kërcënime potenciale të etikës profesionale, si më poshtë:**

1. **Kërcënimi i mundshëm i pavarësisë dhe objektivitetit:** Nëse audituesi zhvillon i vetëm takime të shpeshta me CEO dhe CFO, kjo mund të krijojë afërsi me drejtimin, duke rrezikuar paanshmërinë e auditimit. Ky rrezik shtohet nëse audituesi ndikohet nga presione të mundshme nga ana e drejtuesve të shoqërisë.
2. **Kërcënimi i vetë-rishikimit:** Nëse audituesi ka dhënë këshilla ose sugjerime gjatë takimeve me drejtimin, ekziston rreziku që të auditojë vendimet e ndikuara nga vetë sugjerimet e tij, gjë që çënon pavarësinë dhe integritetin e auditimit. Nëse ky informacion nuk i vihet në dispozicion ortakut të angazhimit, mund të rrisë rrezikun e dhënies së një opinionit të papërshtatshëm auditimi.
3. **Kërcënimi i familjaritetit:** Një marrëdhënie e gjatë dhe e ngushtë me drejtimin mund të dëmtojë gjykimin profesional të auditorit, duke ndikuar në vendime të cilat mund të jenë më të favorshme për klientin. Nëse është krijuar familjaritet, ky perceptim duhet ndarë me ortakun e angazhimit dhe mbikqyrës të tjerë të firmës së auditimit.
4. **Rreziku i konfidencialitetit:** Ortaku i angazhimit nuk duhet të ndajë informacion të detajuar të mbledhur nga angazhimi me ortakët e tjerë pa kufizime të qarta, pasi kjo mund të shkelë konfidencialitetin e klientit. Informacioni i ndarë në mënyrë të pakontrolluar mund të përdoret në mënyrë të papërshtatshme, duke rrezikuar reputacionin e firmës dhe duke çënuar integritetin e auditimit.

**Masat që mund të ndërmerren:**

1. **Rishikim i pavarur i auditimit:** Nëse vërtetohet mundësia e kërcënimit të objektivitetit, vetë rishikimit dhe familjaritetit, propozohet që informacioni i mbledhur të shqyrtohet nga një auditues tjetër i pavarur për të siguruar objektivitet dhe shmangien e çdo ndikimi nga marrëdhëniet me drejtimin.
2. **Ruajtja e konfidencialitetit:** Ortaku i angazhimit duhet të respektojë konfidencialitetin e klientit dhe të mos ndajë informacione të detajuara të mbledhur gjatë takimit me CEO dhe CFO. Çdo shpërndarje informacioni duhet të kufizohet në aspektet kryesore të auditimit, pa zbuluar detaje të ndjeshme.
3. **Deklarata e pavarësisë:** Çdo anëtar i ekipit të auditimit duhet të dorëzojë një deklaratë të pavarësisë për të garantuar që nuk ekziston asnjë lidhje që mund të ndikojë në punën e tij.

- 4. Shkëputje nga dhënia e këshillave manaxheriale:** Audituesi duhet të shmangë në çdo angazhim dhënien e këshillave manaxheriale për të mos rrezikuar që të auditojë vendimet për të cilat ka dhënë rekomandime. Kjo masë është thelbësore për të ruajtur integritetin e auditimit dhe për të shmangur konfliktin e interesit.

## **Ushtrimi 2**

Ju jeni audituesi ligjor i shoqërisë “HELA” që operon si qendër spitalore prej më shumë se 20 vjetësh. Ju ofroni shërbimin e mbajtjes së kontabilitetit dhe përgatitjes së pasqyrave financiare prej 3 vjetësh, dhe këtë vit keni vendosur të ndryshoni grupin e punës, me qëllim adresimin e rrezikut të vetë-rishikimit. Gjatë rishikimit të evidencave kontabël, grupi i punës evidentoi disa medikamente me datë skandence përpara mbylljes së vitit financiar. Ato vijonin të regjistruara në inventar të mbajtur me metodën FIFO. CFO i “HELA” ngulmon që këto medikamente të vijojnë të njihen në inventar dhe gjykon që audituesi ligjor po tejkalon kompetencat e tij, për shkak se ai është kontraktuar vetëm për kryerjen e shërbimeve të kontabilitetit. Përtej kësaj situate, marrdhënia me drejtues të “HELA” ka qënë korrekte dhe nuk janë evidentuar më parë gabime apo mospërputhje nga të dhënat financiare dhe kontabël.

*Kërkohet:* Përshkruani hapat që do të ndërmerrnit për mbylljen e pasqyrave financiare për vitin aktual.

### **Përgjigje:**

#### **1. Identifikimi i gabimit dhe vlerësimi i ndikimit financiar:**

Eksperti do të identifikonte medikamentet me datë skandence që nuk mund të njihen si inventar aktiv dhe do të llogariste sasinë dhe vlerën totale për të vlerësuar ndikimin në inventar dhe pasqyrat financiare, duke marrë parasysh impaktin cilësor dhe sasior.

#### **2. Diskutimi me CFO dhe drejtimin e shoqërisë:**

Eksperti do të zhvillonte një takim me CFO për të shpjeguar se standardet kontabël kërkojnë përjashtimin e medikamenteve të skaduara nga inventari. Ai do të theksonte rëndësinë e përputhshmërisë me metodologjinë FIFO në këtë rast. Në rastin që CFO është i papërgatitur kundrejt një trajtimi të tillë kontabël, eksperti duhet ta informojë mbi rregullat dhe parimet bazë të kontabilitetit referuar këtij trajtimi.

#### **3. Dokumentimi i mosmarrëveshjes:**

Nëse CFO vazhdon të ngulmojë, eksperti do të dokumentonte qartë mosmarrëveshjen dhe arsyetimin profesional përse medikamentet duhet të përjashtohen nga inventari, duke siguruar transparencë për çdo shqyrtim të mundshëm nga auditorët e jashtëm. Dokumentimi duhet të jetë i qartë dhe të ruhet në dosjen e angazhimit për rishikime të mëtejshme dhe kontrolle cilësore.

#### **4. Propozimi i ndryshimit në inventar:**

Eksperti do të propozojë ndryshimin e inventarit për të reflektuar pozicionin e drejtë kontabël të shoqërisë si dhe përputhshmërinë me standardet e raportimit financiar, duke përjashtuar medikamentet e skaduara dhe llogaritur ndikimin në kostot e shitura dhe vlerën e inventarit.

#### **5. Shqyrtimi i efektit në pasqyrat financiare:**

Ai do të rishikonte efektin e këtyre ndryshimeve në pasqyrën e fitimit dhe humbjes, bilancin dhe pasqyrën e flukseve të parasë për të siguruar që ndryshimet të reflektohen saktë në të gjitha pasqyrat financiare.

#### **6. Konsultimi me një ekspert të pavarur:**

Nëse mosmarrëveshja vazhdon, eksperti do të konsultohet me një ekspert të jashtëm të pavarur ose auditues të licencuar për të siguruar trajtimin e duhur kontabël dhe përputhjen me standardet profesionale.

#### **7. Ruajtja e dokumentacionit dhe përputhshmëria ligjore:**

Eksperti do të sigurojë që çdo ndryshim dhe mosmarrëveshje të dokumentohet mirë dhe të përputhet me standardet ligjore dhe profesionale, duke mbrojtur pozicionin e tij si ekspert kontabël dhe ruajtur besueshmërinë e raportimeve financiare.

#### **8. Përgatitja dhe dorëzimi i pasqyrave financiare:**

Pas rregullimit të inventarit dhe pas konsultimeve, eksperti do të përgatisë dhe dorëzojë pasqyrat financiare të vitit aktual, duke reflektuar të gjitha ndryshimet dhe trajtimet kontabël të sakta. Në rastin që CFO refuzon të nënshkruajë pasqyrat financiare, atëherë eksperti pas shqyrtimit dhe konsultimit me anëtarë të tjerë të firmës, mund të vendosë të tërhiqet nga angazhimi duke dokumentuar qartë dhe arsyet.

### **Ushtrimi 3**

Partneri i angazhimit në shoqëri B&D do të kryejë auditimin e pasqyrave financiare të vitit 2024 për bankën Beta. Nderkohe ai ka aplikuar në këtë bankë për të marrë një hua personale dhe po negocion në lidhje me vlerën e huasë dhe normën e interesit.

*Kërkohet:*

- a) Identifikoni kërcënimin
- b) Shpjegoni kërcënimin
- c) Vlerësoni rëndësinë e kërcënit
- d) Përcaktoni veprimet që shoqëria dhe partneri duhet të ndërmarrin, duke përfshirë masat mbrojtëse që duhet të zbatohen për të zvogëluar kërcënimin në nivel të pranueshëm.

#### **Përgjigje:**

Në rast të një huaje që partneri i angazhimit do të marrë në B&D të cilën ai do ta auditojë, krijohet kërcënim i parimit të objektivitetit. Kjo është një hua personale e cila kërcënon punën e partnerit pasi ai duhet të japë një opinion të pavarur në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare të B&D.

Rëndësia e kërcënit lidhet me faktorët më poshtë:

- Vlerën e huasë dhe kushtet e marrjes së saj. Nëse huaja: (i) është me kushte normale tregtare dhe me vlerë të vogël, si dhe (ii) është bërë në rrjedhën normale të biznesit atëherë mund të mos krijohet kërcënim. Në të kundërt, nëse huaja është me vlerë materiale dhe kushte preferenciale ky kërcënim është i lartë.
- Niveli i stafit. Në këtë rast kemi të bëjmë me partnerin e angazhimit kështu që kërcënimin është në nivel të lartë.

Shoqëria e auditimit duhet të analizojë masat mbrojtëse. Një nga masat mbrojtëse mund të jetë që shoqëria e auditimit të vendosi një partner tjetër angazhimi për të kryer auditimin e B&D. Nëse kjo gjë

nuk është e mundur, atëherë duhet që partneri i angazhimit të mos e marrë huane pranë B&D. Nëse edhe kjo gjë nuk është e mundur, atëherë duhet të konsiderohet të hiqet dorë nga angazhimi i auditimit.

#### **Ushtrimi 4**

Një auditues ligjor ka marrë një kërkesë nga një shoqëri koncesionare në sektorin e energjisë së rinovueshme për të kryer shërbimin e auditimit të pasqyrave financiare të vitit 2024. Audituesi nuk ka eksperiencë konkrete me koncesionet në sektorin e energjisë së rinovueshme.

*Kërkohet:*

- a) Cfarë kërcënimesh paraqiten për audituesin ligjor në lidhje me këtë angazhim.
- b) Cfarë masash mund të marrë ai për të ulur kërcënimin/et në një nivel të pranueshëm.

#### **Përgjigje:**

Një nga parimet themelore është Parimi i kompetencës profesionale i cili përcakton që auditori ligjor të zotërojë njohuri dhe aftësi profesionale në nivelin që kërkohet për të garantuar që klientet të marrin shërbime profesionale kompetente. Në këtë rast kërcënohet parimi i kompetencës profesionale pasi auditori ligjor nuk ka eksperiencë konkrete me koncesionet në sektorin e energjisë së rinovueshme.

Auditori ligjor mund të marrë disa masa për të ulur kërcënimin duke përfshirë se pari trainimet e grupit të punës (stafi dhe partneri i angazhimit) në fushën përkatëse. Gjithashtu, duhet të konsiderohet të përfshihet në grupin e punës një nën-kontraktor që ka eksperiencë konkrete në fushën përkatëse. Vetëm pasi të bëhet e mundur që kërcënimin të ulur në nivel të pranueshëm, shoqëria e auditimit do të pranojë kryerjen e këtij angazhimi.

#### **Ushtrimi 5**

Një profesionist kontabël operon në situata dhe rrethana të cilat mund të çojnë në kërcënime specifike ndaj respektimit të parimeve themelore. Kodi i Etikës, përmban edhe Një Kuadër Konceptual i cili i vjen në ndihmë profesionistëve kontabël në respektimin e parimeve themelore dhe përmbushjen e përgjegjësisë së tyre për të vepruar në interes të publikut.

*Kërkohet:* Cilat janë specifikimet e Kuadrit Konceptual që një auditues ligjor duhet të aplikojë?

#### **Përgjigje:**

Kuadri konceptual specifikon rrethanat kur një profesionist kontabël:

- (a) Identifikon kërcënimet kundrejt pajtueshmërisë me parimet themelore;
- (b) Vlerëson kërcënimet e identifikuar; dhe
- (c) Adreson kërcënimet duke i eliminuar ose zvogëluar ato deri në një nivel të pranueshëm.

Profesionisti kontabël do të zbatojë parimet themelore për të identifikuar, vlerësuar dhe trajtuar kërcënimet që i bëhen respektimit të parimeve themelore. Kur merret me një çështje etike, profesionisti kontabël do të marrë në konsideratë kontekstin në të cilin ka lindur ose mund të lindë çështja. Kur një individ, i cili është një profesionist kontabël në praktikën publike, kryen veprimtari profesionale në përputhje me marrëdhënien e profesionistit me firmën, qoftë si kontraktues, punonjës apo pronar,

individit duhet të veprojë në përputhje me dispozitat që duhet të zbatohen në këto rrethana. Gjatë zbatimit të kuadrit konceptual, profesionisti kontabël do të:

- (a) Përdorë gjykimin profesional;
- (b) Qëndrojë vigjilent për informacione të reja dhe ndryshime në fakte e rrethana; dhe
- (c) Përdorë testin e arsyeshëm dhe të informuar të palës së tretë

Një mendje kërkuese është një parakusht për të kuptuar faktet dhe rrethanat e njohura, të nevojshme për zbatimin e duhur të kuadrit konceptual. Të paturit e një mendje kërkuese përfshin:

- (a) Vlerësimin e burimit, përshtatshmërisë dhe mjaftueshmërisë së informacionit të siguar, duke mbajtur parasysh natyrën, shtrirjen dhe rezultatet e veprimtarisë profesionale që është ndërmarrë; dhe
- (b) Të qenurit i hapur dhe vigjilent ndaj nevojës për investigime të mëtejshme ose veprime të tjera.

## **Ushtrimi 6**

Gjate angazhimit në një klient, audituesit ligjor i kërket shërbimi për auditimin e brendshëm po nga i njëjti klient. Për këtë qëllim, kërket që të vendosen një sërë masash mbrojtëse për angazhimin në procesin e auditimit të brendshëm.

*Kërket:* A do ishte e lejueshme pranimi i angazhimit për shërbimin e auditimit të brendshëm, dhe nëse po cilat do ishin masat mbrojtëse që duhet të vendose audituesi ligjor?

### **Përgjigje:**

Shërbimet e auditimit të brendshëm përfshijnë një gamë të gjerë aktiviteteve dhe mund të përfshijnë ndihmën e klientit të auditimit në kryerjen e një ose më shumë aspekteve të aktiviteteve të tij të auditimit të brendshëm. Aktivitetet e auditimit të brendshëm mund të përfshijnë:

- Monitorimin e kontrollit të brendshëm – rishikimin e kontrolleve, monitorimin e operacioneve të tyre rekomandimin për përmirësimet e tyre.
- Ekzaminimin e informacionit financiar dhe operativ nëpërmjet
  - Rishikimit të mjeteve të përdorura për të identifikuar, matur, klasifikuar dhe raportuar informacionin financiar dhe operativ.
  - Kërkimi specifik për artikujt individualë, duke përfshirë testimin e detajuar të transaksioneve, tepricave dhe procedurave.
- Rishikimi i ekonomisë, efikasitetit dhe efektivitetit të aktiviteteve operative duke përfshirë aktivitetet jo financiare të entitetit.
- Rishikimi i përputhshmërisë me: Ligjet, rregulloret dhe kërkesat e tjera të jashtme, Politikën e menaxhimit, direktivat dhe kërkesat e tjera të brendshme.

Objekti dhe objektivat e aktiviteteve të auditimit të brendshëm ndryshojnë shumë dhe varen nga madhësia dhe struktura e entitetit dhe kërkesat e personave të ngarkuar me qeverisjen si dhe nevojat dhe pritshmëritë e menaxhimit. Meqenëse ato mund të përfshijnë çështje që janë operacionale në natyrë, ato nuk lidhen domosdoshmërisht me çështje që do të jenë subjekt i vlerësimit në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare.



Dhënia e shërbimeve të auditimit të brendshëm për një klient auditimi mund të krijojë një kërcënim të vetë-rishikimit, kur ekziston rreziku që rezultatet e shërbimeve të ndikojnë në auditimin e pasqyrave financiare për të cilat firma do të shprehë një opinion.

Dhënia e shërbimeve të auditimit të brendshëm për klientët e auditimit që nuk janë entitete me interes publik do të ishte e lejueshme. Një shembull i një veprimi që mund të jetë një masë mbrojtëse për të trajtuar një kërcënim të vetë-rishikimit të krijuar nga dhënia e një shërbimi të auditimit të brendshëm për një klient të auditimit që nuk është një entitet me interes publik, është përfshirja e profesionistëve që nuk janë anëtarë të ekipit të auditimit për të kryer shërbimin.

## **Ushtrimi 7**

Shoqëria e auditimit ABC është duke vlerësuar efektivitetin e programit të kualifikimit të vijueshëm dhe efektivitetin që ka ky program mbi cilësinë e angazhimeve të auditimit.

*Kërkohet:*

- a) Të vlerësohet se cilat janë masa mbrojtëse që një program i kualifikimit të vijueshëm merr parasysh
- b) Këto masa mbrojtëse a do të adresojnë kërcënimin e vetë-rishikimit?

## **Përgjigje:**

Një shoqëri auditimi ose profesionist kontabel duhet të sigurohet që profesionistët e saj të auditimit t'i nënshtrohen trajnimeve të rregullta për ruajtjen e objektivitetit dhe trajtimin e kërcënimeve të vetë-rishikimit.

Për shembull, mund të zhvillojë seminare ose seminare që fokusohen në standardet etike dhe kërcënimet e vetë-rishikimit. Ky trajnim i ndihmon auditorët të qëndrojnë vigjilentë rreth çështjeve të mundshme të vetë-rishikimit dhe t'u përmbahen praktikave më të mira.

Duke zbatuar këto masa mbrojtëse në praktike, firmat e auditimit mund të trajtojnë në mënyrë efektive kërcënimin e vetë-rishikimit dhe të ruajnë integritetin dhe cilësinë e angazhimeve të tyre të auditimit.